

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

P.nr. 147/2014

Mitrovicë, 10 dhjetor 2015

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Vidar Stensland si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarja e EULEX-it Franciska Fiser dhe gjyqtarja e EULEX-it Katrien Gabriël Witteman si anëtarë të trupi gjykues, me zyrtaren ligjore të EULEX-it Vera Manuello si procesmbajtëse, ka kryer shqyrtimin gjyqësor në lëndën penale P.nr. 147/2014 kundër:

R.K. _____ (i njohur si “**R.** _____”), i lindur më _____ në _____, Komuna _____; emri i babait: U. _____, emri i nënës: K.B. _____; i kombësisë serbe; i martuar; me banim në _____, Komuna _____, Kosovë; Nr. i letërnjoftimit.: _____ lëshuar nga _____;

dhe

S.S. _____ (i njohur si “**B.** _____”), i lindur më _____ në _____; emri i babait: D. _____, emri i nënës: M.M. _____; i kombësisë serbe; i martuar; me banim në _____, _____, Kosovë; Nr. i letërnjoftimit.: _____ lëshuar nga _____;

Akuzuar përmes aktakuzës së prokurorit të EULEX-it në Mitrovicë, të datës 12 dhjetor 2014 dhe paraqitur në shkrimore të njëjtën ditë, plotësuar më 17 prill 2015, pasi një pikë e aktakuzës (Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve) është refuzuar nga gjykata pas shqyrtimit fillestar, vendim i cili është konfirmuar nga Gjykata e Apelit në aktvendimin lidhur me ankesat PN 254/15, të datës 11 qershor 2015, për kryerjen e veprave penale:

Pika e akuzës 1: Vrasje e rëndë, pika e akuzës 2: Vrasje e rëndë në tentativë, pika e akuzës 3: Pengimi i personave zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, pika e akuzës 4: Shkaktimi i

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

P.nr. 147/2014

Mitrovicë, 10 dhjetor 2015

rrezikut të përgjithshëm, pika e akuzës 5: Rrezikimi i trafikut publik me veprim apo mjete të rrezikshme, pika e akuzës 6: Pjesëmarrja në grup që kryen vepër penale, të gjitha akuzat të kryera në bashkë-kryerje.

Seancat e shqyrtimit gjyqësor, të hapura për publikun, janë mbajtur më datat 18 dhe 29 shtator 2015, 16, 26 dhe 30 tetor 2015, 11 dhe 30 nëntor 2015, 03 dhe 07 dhjetor 2015; seanca e datës 11 nëntor 2015 në ora 09:45 deri në ora 12:00 është mbyllur për publikun. Të gjitha seancat janë mbajtur në praninë e të pandehurit **R.K.** _____, avokatin e tij mbrojtës Miodrag Brkljac (zëvendësuar nga avokati mbrojtës Miro Delevic më datën 18 shtator 2015 dhe 26 dhe 30 tetor 2015), të pandehurit **S.S.** _____, avokatin e tij mbrojtës Dobrica Lazic, prokurores Neeta Amin (zëvendësuar nga prokurorja e EULEX-it Lili Oprea Steluta më datën 18 shtator 2015 dhe 30 nëntor 2015 dhe nga prokurori i EULEX-it Tomas Skala më datën 16 tetor 2015), palëve të dëmtuara D.Z. _____, B.M. _____, D.P. _____¹ dhe përfaqësuesit të tyre ligjor Burhan Maxhuni (zëvendësuar nga Eron Prekazi më datën 30 nëntor dhe 07 dhjetor 2015).

Trupi gjykues ka mbajtur këshillimin dhe ka votuar më datën 07 dhjetor 2015.

Në pajtim me nenin 366 paragrafin (1) të Kodit të Procedurës Penale (KPP²), më datën 10 dhjetor 2015, në seancë publike dhe në praninë e personave të akuzuar, avokatëve të tyre mbrojtës dhe prokurorit të EULEX-it, palët e dëmtuara dhe përfaqësuesi i tyre;

Trupi gjykues shpall si në vijim:

AKTGJYKIM:

I

Pika e akuzës 3 (Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare):

¹ Palët e dëmtuara nuk ishin të pranishme në të gjitha seancat, në procesverbal është deklaruar se kush ishte i pranishëm në secilën seancë.

² Ligji Nr. 04/L-123.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

P.nr. 147/2014

Mitrovicë, 10 dhjetor 2015

R.K. _____ **shpallet FAJTOR** për shkak se është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:

Më datën 26 korrik 2011, rreth orës 13:30, më shumë se 50 _____ të Kosovës, pjesëtarë të _____ (_____), të cilët ishin në gjendje gatishmërie në _____ bazën që ndodhet në _____, morën një urdhër për t'u nisur në drejtim të pikës kufitare G 31 në mënyrë që të merrej kontrolli i pikës kufitare. Konvoji prej _____ automjete, në këtë mënyrë u largua nga _____ baza. Konvoji përbëhej nga dy automjete të blinduara (njëri prej tyre ishte duke e udhëhequr konvojën dhe i dyti ishte në fund të konvojit) dhe për afërsisht dhjetë deri në dymbëdhjetë _____ automjete ishin në mes të automjeteve të blinduara. Derisa vazhduan drejt pikës kufitare G 31 përgjatë rrugës kryesore të asfaltuar në mes të Mitrovicës dhe Zubin Potokut, në pjesën që gjendet në mes të fshatit Varage dhe fshatit Zupç, _____ konvoji ka hasur në katër deri në pesë automjete që po vinin nga ana e kundërt. Automjetet që po afroheshin u ndalën dhe krijuan një barrikadë, e cila bllokoi rrugën dhe e detyroi _____ konvojën të ndalej. Njerëzit në këto automjete, rreth gjashtë deri në tetë persona, dolën jashtë dhe filluan të përballeshin me _____ duke bërë titur dhe duke u bërë me gjeste atyre që të ktheheshin prapa. Njëri prej këtyre personave ishte **R.K.** _____.

Disa _____ i urdhëruan (në gjuhën serbe dhe shqipe) personat të cilët e kishin bllokuar dhe e pengonin autostradën publike që t'i largonin veturat e tyre. Këta persona nuk iu bindën atij urdhëri dhe vazhduan të ulërinin dhe bërtisnin në _____, duke bërë me gjeste dhe duke u ngritur atyre gishtat. Në atë moment, _____ udhëheqësi i operacionit dha urdhër që automjeti i blinduar duhet të vazhdojë t'i shtyjë automjetet e barrikadës. Sapo automjeti i blinduar iu afrua automjeteve që e kishin bllokuar rrugën, personat që po qëndronin prapa barrikadës u larguan nga barrikada. **R.K.** _____ mori pjesë në kryerjen e veprës penale si një pjesëmarrës aktiv në grupin e personave, të cilët me veprimin e përbashkët siç është përshkruar, kanë penguar _____ konvojën në detyrën e tyre për të shkuar në pikën kufitare G 31.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

P.nr. 147/2014

Mitrovicë, 10 dhjetor 2015

R.K. _____ ishte i aftë mendërisht kur kreu veprën penale dhe ai e kreu këtë veprë penale me dashje direkte.

Në këtë mënyrë **R.K.** _____ **DËNOHET** për kryerjen e veprës penale:

Pengimi i personave zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në shkelje të nenit 318 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPK)³, aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 409 paragrafit (2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)⁴, *përmes së cilës gjykata ri kualifikon akuzën fillestare të Pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare* në shkelje të nenit 316 paragrafët (1) dhe (3) të KPK-së, siç lexohet në lidhje me nenin 23 të KPK-së, aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 409 paragrafët (1) dhe (2) të KPRK-së siç lexohet në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

Në këtë mënyrë, në pajtim me nenin 318 të KPK-së, **R.K.** _____

DËNOHET

me

gjashtë (6) muaj burgim.

Në pajtim me nenin 43 paragrafët (1) dhe (2) dhe nenin 44 paragrafët (1) të KPK-së, dënimi me burgim i shqiptuar ndaj **R.K.** _____ nuk do të ekzekutohet nëse ai nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale gjatë kohës së verifikimit prej **dy (2) viteve**.

S.S. _____ shpallet **I PAFAJSHËM**

Për kryerjen e veprës penale të pengimit të personave zyrtar në kryerjen e detyrave, në aktakuzën e përshkruar si në vijim:

³ RREGULLORJA E UNMIK-ut/2003/25.

⁴ Ligji Nr. 04/L-082.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

P.nr. 147/2014

Mitrovicë, 10 dhjetor 2015

Më 26 korrik 2011 në mes orës 13:30 deri 14:15 në zonën që ndodhet mes fshatit Varage dhe fshatit Zupç në komunën e Zubin Potokut, në komunën e Zubin Potokut, në bashkëkryerje me persona të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, duke kontribuar thelbësisht nëpërmjet sjelljes së tyre të qëllimshme dhe paligjshme dhe me veprime që qenë pjesë e grupit të cekur të personave kanë përdorur forcë dhe kërcënime të rënda për të penguar _____ në *locus in quo* në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare të ligjshme,

Për shkak se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ai i ka kryer veprimin në fjalë.

Në këtë mënyrë, bazuar në nenin 364 paragrafin (1) nën-paragrafin (1.3) të KPP-së, **S.S.** _____ **lirohet nga vepra penale e**

Pengimit të personave zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në shkelje të nenit 316 paragrafët (1) dhe (3) të KPK-së siç lexohet në lidhje me nenin 23 të KPK-së, aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 409 paragrafëve (1) dhe (2) të KPRK-së siç lexohet në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

Pika e akuzës 1 (Vrasja e rëndë):

R.K. _____ dhe **S.S.** _____ shpallen **TË PAFAJSHËM**

Për veprën penale të vrasjes së rëndë, në aktakuzën e përshkruar si në vijim:

Më 26 korrik 2011 në mes orës 13:30 deri 14:15 në zonën që ndodhet mes fshatit Varage dhe fshatit Zupç në komunën e Zubin Potokut, në bashkëkryerje me persona të tjerë, kanë vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, duke kontribuar thelbësisht nëpërmjet sjelljes së tyre të qëllimshme dhe të paligjshme dhe me veprime që kanë qenë pjesë e grupit të cekur të personave në kryerjen e veprës penale të Vrasjes së rëndë e privuan nga jeta E.Z. _____ për motive racore dhe kombëtare për shkak të kombësisë së tij shqiptare

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

P.nr. 147/2014

Mitrovicë, 10 dhjetor 2015

dhe kosovare në kohën kur E.Z. _____ ishte duke i kryer detyrat e tij të ligjshme të mbrojtjes së rendit juridik, duke mbrojtur rendin ligjor, mbrojtjen e personave apo të pronës, mbrojtjen e personave apo të pronës dhe mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike dhe duke vepruar kështu qëllimisht iu rrezikuan jetën e udhëtarëve në automjet.

Për shkak se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ata kanë kryer veprimin në fjalë.

Në këtë mënyrë, bazuar në nenin 364 paragrafin (1) nënparagrafin (1.3) të KPP-së, **R.K.** _____ dhe **S.S.** _____ **LIROHEN** nga vepra penale

Vrasje e Rëndë, në kundërshtim me nenet 146 dhe 147 paragrafët (4), (6), (8) dhe (10) të KPK-së, siç lexohet në lidhje me nenin 23 të KPK-së, aktualisht e ndëshkueshme sipas neneve 178 dhe 179, nënparagrafëve (1.5), (1.7), (1.9) dhe (1.10) të KPRK-së, siç lexohet në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

Pika e akuzës 2 (Vrasje e rëndë në tentativë):

R.K. _____ dhe **S.S.** _____ shpallen **TË PAFAJSHËM**

për veprën penale Vrasje e rëndë në tentativë, e përshkruar në aktakuzë si në vijim:

Më 26 korrik 2011 ndërmjet orës 13:30 deri 14:15 në zonën e cila ndodhet në mes të fshatit Varage dhe fshatit Zupç të komunës së Zubin Potokut, në bashkëkryerje me persona të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, thelbësisht duke kontribuar me sjelljen e tyre të qëllimshme dhe të paligjshme dhe me veprime që qenë pjesë e grupit të cekur të personave në kryerjen e veprës penale të Vrasjes së rëndë në tentativë që t'i privonin nga jeta udhëtarët e tjerë (_____ B.M. _____ dhe D.P. _____) në veturë me palën e dëmtuar, të ndjerin E.Z. _____ për motive racore dhe kombëtare për shkak të kombësisë së tij shqiptare dhe kosovare në kohën kur E.Z. _____ ishte duke i kryer detyrat e

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

P.nr. 147/2014

Mitrovicë, 10 dhjetor 2015

tij të ligjshme të mbrojtjes së rendit juridik, duke mbrojtur rendin ligjor, mbrojtjen e personave apo të pronës, mbrojtjen e personave apo të pronës dhe mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike dhe duke vepruar kështu qëllimisht iu rrezikuan jetët e _____ B.M. _____, D.P. _____ dhe të tjerëve _____ në konvojin e automjeteve në *locus in quo*.

Sepse nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ata e kanë kryer veprën në fjalë.

Në këtë mënyrë, bazuar në nenin 364 paragrafin (1) nen-paragrafin (1.3) të KPP-së, **R.K.** _____ dhe **S.S.** _____ **LIROHEN** nga vepra penale

Vrasje e rëndë në tentativë, në shkelje të neneve 146 dhe 147 paragrafët (4), (6), (8) dhe (10) të KPK-së, siç lexohet në lidhje me nenet 20 dhe 23 të KPK-së aktualisht e ndëshkueshme sipas neneve 178 dhe 179, nënparagrafëve (1.5), (1.7), (1.9) dhe (1.10) të KPRK-së, siç lexohet në lidhje me nenet 28 dhe 31 të KPRK-së.

Pika e akuzës 4 (Rrezikimit të trafikut publik me veprim apo mjete të rrezikshme):

R.K. _____ dhe **S.S.** _____ shpallen **TË PAFAJSHËM**

për veprën penale Rrezikim të trafikut publik me veprim apo mjete të rrezikshme, e përshkruar në aktakuzë si në vijim:

Më 26 korrik 2011 ndërmjet orës 13:30 deri 14:15 në zonën e cila ndodhet në mes të fshatit Varage dhe fshatit Zupç të komunës së Zubin Potokut, në bashkëkryerje me persona të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, thelbësisht duke kontribuar me sjelljen e tij të qëllimshme dhe të paligjshme dhe me veprime që qenë pjesë e grupit të cekur të personave kanë shkatërruar, hequr dhe dëmtuar seriozisht autostradën publike nga Mitrovica në drejtim të Zubin Potokut në zonën që ndodhet midis fshatrave Varage dhe Zupç, të Zubin Potokut duke dhënë shenja të gabuara, sinjale, duke vendosur pengesa dhe

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

P.nr. 147/2014

Mitrovicë, 10 dhjetor 2015

barrikada në rrugë publike në fjalë në këtë mënyrë e kanë rrezikuar trafikun, jetën e njeriut, sigurinë fizike dhe pronat në shkallë të gjerë.

Sepse nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ata e kanë kryer veprën në fjalë.

Në këtë mënyrë, bazuar në nenin 364 paragrafin (1) nënparagrafin (1.3) të KPP-së, **R.K.** _____ dhe **S.S.** _____ **LIROHEN** nga vepra penale

Rrezikimit të trafikut publik me veprim apo mjete të rrezikshme, në shkelje të nenit 299 paragrafit (1) të KPK-së, siç lexohet në lidhje me nenin 23 të KPK-së, aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 380 paragrafit (1) të KPRK-së, siç lexohet në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

Pika e akuzës 5 (Shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm):

R.K. _____ dhe **S.S.** _____ shpallen **TË PAFAJSHËM**

për veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, e përshkruar në aktakuzë si në vijim:

Më 26 korrik 2011 ndërmjet orës 13:30 deri 14:15 në zonën e cila ndodhet në mes të fshatit Varage dhe fshatit Zupç të komunës së Zubin Potokut, në bashkëkryerje me persona të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, thelbësisht duke kontribuar me sjelljen e tij të qëllimshme dhe të paligjshme dhe me veprime që qenë pjesë e grupit të cekur të personave kanë shkatërruar, hequr dhe dëmtuar seriozisht autostradën publike nga Mitrovica në drejtim të Zubin Potokut në zonën që ndodhet midis fshatrave Varage dhe Zupç, të Zubin Potokut me armë, pengesa dhe barriera të tjera të cilat shkaktuan vdekjen e E.Z. _____ dhe dëme të konsiderueshme materiale autostradës publike dhe automjeteve _____ dhe rrezik të madh për të tjerë të _____ të pranishëm në konvojin e automjeteve në *locus in quo*.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

P.nr. 147/2014

Mitrovicë, 10 dhjetor 2015

Sepse nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ata e kanë kryer veprën në fjalë.

Në këtë mënyrë, bazuar në nenin 364 paragrafin (1) nënparagrafin (1.3) të KPP-së, **R.K.**

_____ dhe **S.S.** _____ **LIROHEN** nga vepra penale

Shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm, në shkelje të nenit 291 paragrafit (1), (3) dhe (5) të KPK-së, siç lexohet në lidhje me nenin 23 të KPK-së, aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 365 të KPRK-së, siç lexohet në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

Pika e akuzës 6 (Pjesëmarrjes në grup që kryen veprë penale):

R.K. _____ dhe **S.S.** _____ shpallen **TË PAFAJSHËM**

për veprën penale Pjesëmarrje në grup që kryen veprë penale, e përshkruar në aktakuzë si në vijim:

Më 26 korrik 2011 ndërmjet orës 13:30 deri 14:15 në zonën e cila ndodhet në mes të fshatit Varage dhe fshatit Zupç të komunës së Zubin Potokut, në bashkëkryerje me persona të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, thelbësisht duke kontribuar me sjelljen e tij të qëllimshme dhe të paligjshme dhe me veprime që qenë pjesë e grupit të cekur të personave kanë marrë pjesë në turmën e mbledhur të cilët u mblodhën në *locus in quo* që me veprimet e tyre të grumbullimit e privuan nga jeta E.Z. _____ përmes shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm, dëmeve në automjetet e _____ në shkallë të gjerë dhe me veprat e tjera penale të dhunës së rëndë kundër _____ të pranishëm në konvojin e automjeteve në *locus in quo*.

Sepse nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ata e kanë kryer veprën në fjalë.

Në këtë mënyrë, bazuar në nenin 364 paragrafin (1) nënparagrafin (1.3) të KPP-së, **R.K.**

_____ dhe **S.S.** _____ **LIROHEN** nga vepra penale

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

P.nr. 147/2014

Mitrovicë, 10 dhjetor 2015

Pjesëmarrje në grup që kryen vepër penale, në shkelje të nenit 320 paragrafit (1) të KPK-së siç lexohet në lidhje me nenin 23 të KPK-së, aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 412 të KPRK-së, siç lexohet në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

II

R.K. _____ detyrohet të kompensojë **shpenzimet e procedurës penale** në shumën prej (200) eurove, por lirohet nga detyrimi i kompensimit të pjesës tjetër në përputhje me nenin 453 paragrafin (1) dhe (4) të KPP-së. I akuzuari **R.K.** _____ duhet të kompensojë shumën e urdhëruar jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë. Çdo shpenzim i mbetur do të paguhet nga mjetet buxhetore.

III

Në përputhje me nenin 463 të KPP-së, pala e dëmtuar D.Z. _____ udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil.

IV

KËSHILLË JURIDIKE: Ndaj këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë nga ana e të pandehurve, avokatëve të tyre mbrojtës, prokurorit, në përputhje me nenin 380 paragrafin (1) dhe 381 paragrafin (1) të KPP-së brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dorëzimit të aktgjykimit të arsyetuar plotësisht. Ankesa eventuale mund të paraqitet në gjykatën e shkalles së parë sipas nenit 388 paragrafit (1) të KPP-së.

Gjykata Themelore në Mitrovicë

P. Nr. 147/2014

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

P.nr. 147/2014

Mitrovicë, 10 dhjetor 2015

Gjyqtare e EULEX-it

Kryetari i trupit gjykues i EULEX-it

Gjyqtare e EULEX-it

Franciska Fiser

Vidar Stensland

Katrien Gabriël Witteman

Procesmbajtëse

Vera Manuello